



CLARKU PËRMBYLL DËSHMINË E TIJ NË HAGË: THAÇI NUK MBAN PËRGJEGJËSI PËR AKTET E DHUNËS NË KOSOVË

Wesley Clark, gjeneral i pensionuar amerikan, dëshmoi për dy ditë në mbrojtje të Hashim Thaçit në Hagë. Në ditën e parë të dëshmisë, ai tha se Thaçi s'e udhëhiqte UÇK-në dhe se ajo s'kishte zinxhir komandues. Ndërkaq, në ditën e dytë tha se Thaçi nuk mbante përgjegjësi për aktet e dhunës në Kosovë. Në fund të dëshmisë së tij, ai i kërkoi trupit gjykues që ta lejonte të jepte një vlerësim të tij për rastin gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Ai përsëriti bindjen që Thaçi nuk mban përgjegjësi për aktet e dhunës apo hakmarrjes që kanë ndodhur në Kosovë

AGJENCIA E MENAXHIMIT EMERGJENT: SITUATA ME VËRSHIMET, NËN KONTROLL



PËR NËNTË MUAJ MORËN TRAJTIM MJEKËSOR NË QKUK 77 MIJË E 655 PACIENTË



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

DËSHMIA E WESLEY CLARKUT, E VËRTETA E LUFTËS NË KOSOVË

Shkruan: Akademik
Arsim BAJRAMI



AKTUALE



KËSHILLI I SIGURIMIT I OKB-së E MIRATON REZOLUTËN PËR PLANIN E TRUMPIT PËR GAZËN

KURTI: MBI 12 MIJË GRA TË PUNËSUARA DREJTPËRDREJT NGA PROGRAMET E PUNËSIMIT

EKONOMI



PRODHUESIT NË KRIZË: LIBERALIZIMI I ENERGJISË RRITI ÇMIMET, ULI KAPACITETET

SPORT



"PENDOHET" JUVENTUSI, TANI E DUAN ME ÇDO KUSHT GRANIT XHAKËN 10

KËSHILLI I SIGURIMIT I OKB-së E MIRATON REZOLUTËN PËR PLANIN E TRUMPIT PËR GAZËN

NJU-JORK, 18 NËNTOR - Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e miratoi të hënën në orët e vona një rezolutë të hartuar nga Shtetet e Bashkuara, e cila e mbështet planin e presidentit Donald Trump për t'i dhënë fund luftës në Rripin e Gazës. Rezoluta gjithashtu autorizon një forcë ndërkombëtare për stabilizim në enklavën palestineze. Izraeli dhe grupi palestinez i shpallur terrorist nga ShBA dhe fuqi të tjera, Hamas, u pajtuan muajin e kaluar për fazën e parë të planit 20-pikësh të Trumpit për Gazën - një armëpushim në luftën e tyre dyvjeçare dhe një marrëveshje për lirin e pengjeve. Por, rezoluta e OKB-së shihet si thelbësore për ta legjitimuar një organ të përkohshëm qeverisës dhe për t'iu ofruar garanci vendeve që po shqyrtojnë dërgimin e trupave në Gazë. Teksti i rezolutës thotë se shtetet anëtare mund të marrin pjesë në Bordin e Paqes të kryesuar nga Trumpi, i konceptuar si një autoritet tranzitor që do ta mbikëqyrte rindërtimin dhe

rimëkëmbjen ekonomike të Gazës. Ai gjithashtu autorizon forcën ndërkombëtare të stabilizimit, e cila do të siguronte procesin e çmilitarizimit të Gazës, përfshirë shkatërrimin e armëve dhe infrastrukturës ushtarake. Hamas, në një komunikatë, e përsëriti se nuk do të çarmatoset dhe argumentoi se lufta e tij kundër Izraelit është qëndresë legjitime. “Rezoluta vendos një mekanizëm të kujdestarisë ndërkombëtare mbi Rripin e Gazës, të cilin populli ynë dhe fraksionet tona e kundërshtojnë”, tha Hamas në komunikatën e lëshuar pas miratimit të rezolutës. Mike Waltz, ambasadori amerikan në OKB, tha se rezoluta, e cila përfshin planin 20-pikësh të Trumpit si aneks, “hap një rrugë të mundshme drejt vetëvendosjes për palestinezët ... ku në vend të raketave do të ketë degë të ullirit dhe ku ekziston mundësia për t'u pajtuar për një horizont politik”. Rusia, e cila ka të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit, e kishte



lënë të hapur më herët mundësinë e kundërshtimit, por u përmbajt nga votimi, duke lejuar që rezoluta të kalojë. Ambasadorët e Rusisë dhe Kinës në OKB, që gjithashtu u përmbajtën, u ankuan se rezoluta nuk i jep OKB-së rol të qartë në të ardhmen e Gazës. “Në thelb, këshilli po i jep bekimin e tij një nisme amerikane bazuar në premtimet e Uashingtonit, duke i dhënë kontroll të plotë mbi Rripin e Gazës Bordit të Paqes dhe ISF-së (forcës ndërkombëtare të stabilizimit),

modalitetet e të cilave nuk i dimë ende”, tha ambasadori rus Vasily Nebenzya pas votimit. Autoriteti Palestinez e përshëndeti rezolutën dhe tha se është i gatshëm të marrë pjesë në zbatimin e saj. Diplomatat thanë se mbështetja e autoritetit për rezolutën javën e kaluar ishte vendimtare për të parandaluar veton ruse. Trump e festoi votimin si “një moment me përmasa vërtet historike” në një postim në rrjetet sociale. “Anëtarët e Bordit dhe shumë njoftime të tjera emocionuese do të bëhen

publike në javët në vijim”, shkroi ai.

“Rrugë” drejt shtetësisë

Rezoluta është bërë e diskutueshme në Izrael sepse përmend mundësinë e shtetësisë palestineze në të ardhmen. Teksti i rezolutës thotë se “mund të jenë krijuar më në fund kushtet për një rrugë të besueshme drejt vetëvendosjes dhe shtetësisë palestineze”, pasi Autoriteti Palestinez të ketë zbatuar një program reformash dhe rindërtimi i Gazës të ketë shënuar përparim. “Shtetet e Bashkuara do të krijojnë dialog midis Izraelit dhe palestinezëve për të arritur pajtueshmëri për një horizont politik për bashkëjetesë paqësore dhe të begatë”, thuhet në dokument. Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, nën presion nga anëtarët e krahut të djathtë të Qeverisë së tij, tha të dielën se Izraeli vazhdon të jetë kundër një shteti palestinez dhe premtoi se do ta çmilitarizojë Gazën “në mënyrën e lehtë ose të vështirë”.

SHEFJA E KE-së THOTË SE JANË TRI OPSIONE PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË UKRAINËS

BRUKSEL, 18 NËNTOR - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, përmes një letre dërguar qeverive të Bashkimit Evropian më 17 nëntor tha se janë tri opsione për të përmbushur nevojat financiare të Ukrainës, përfshirë një kredi duke përdorur asetet e ngrira ruse, por edhe kombinimi i të tri opsioneve është i mundur. Muajin e kaluar, udhëheqësit e BE-së u pajtuan që të përmbushin “nevojat urgjente financiare” të Ukrainës për dy vjetët e ardhshëm, por nuk miratuan një plan për përdorimin e aseteve të ngrira ruse për të financuar një hua të madhe për Kievin, për shkak të shqetësimeve të ngritura nga Belgjika. Udhëheqësit e të gjitha vendeve

të BE-së, përveç Hungarisë, kërkuar nga KE-ja që të propozojë opsione për mbështetjen financiare të Ukrainës, shtet që po lufton me Rusinë që nga viti 2022. “Ne kemi identifikuar tri opsione kryesore, pra mbështetje e financuar nga shtetet anëtare përmes granteve, një hua me përgjegjësi të kufizuar e financuar nga Bashkimi Evropian duke marrë hua në tregjet financiare, ose një hua me përgjegjësi të kufizuar e lidhur me bilancet e parave të aseteve të ngrira”, tha von der Leyen në letrën, raporton Reuters. Në një dokument opsionesh, që i është bashkëngjitur letrës, Von der Leyen shtoi se “tri opsionet nuk janë të ndërsjella. Ato mund



të kombinohen ose të zbatohen njëra pas tjetrës”. “Duke pasur parasysh urgjencën e situatës, kompleksitetin e ndryshëm të opsioneve dhe nevojën për të nisur shpërndarjet deri në tremujorin e dytë të vitit 2026, çdo opsion i zgjedhur mund të dizajnohet si kalimtar dhe i kufizuar në kohë”, thuhet në dokument. Si një shembull, dokumenti përmend se opsioni i mbështetjes

financiare, pa mundësi kthimi, të financuar nga vendet anëtare dhe opsioni i huamarrjes nga BE-ja në tregjet financiare “mund të shërbejnë si zgjidhje të përkohshme” deri sa të miratohet buxheti i ri afatgjatë i bllokut, që hyn në fuqi më 2028, dhe mund të shërbejë si garanci për kreditë e financuara nga BE-ja. Dokumenti vlerëson se nevoja financiare e Ukrainës për vitet 2026-2027 arrin në 135.7 miliardë euro. Propozimi i KE-së për përdorimin e aseteve të ngrira ruse do të prodhonte një hua prej 140 miliardë eurosh, duke mbuluar nevojat e Kievit. Nëse zgjidhet opsioni i granteve, Ukraina do të kishte nevojë për të paktën 90 miliardë euro nga vendet anëtare të BE-së për dy vjetët e ardhshëm, thuhet në

dokument. Në letrën e saj, Von der Leyen i tha kryeqyteteve evropiane se është e nevojshme një vendim i shpejtë. “Tani do të jetë kyç të arrihet shpejt një angazhim i qartë mbi mënyrën se si do të sigurohet që financimi i nevojshëm për Ukrainën të miratohet në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Evropian në muajin dhjetor”, tha ajo. Nga 135.7 miliardë euro të nevojshme gjatë dy vjetëve, Ukraina do të kishte nevojë për 83.4 miliardë euro vetëm për ushtrinë dhe 52.3 miliardë për shpenzime të tjera, sipas dokumentit. Nevojat do të jenë më të mëdha në vitin 2026, duke arritur në 71.7 miliardë euro, dhe më të vogla në vitin 2027, 64 miliardë euro, sipas dokumentit.

Mali i Zi paralajmëron ambasadorin rus se deklaratat e tij do të trajtohen si veprimtari armiqësore



Podgoricë, 18 nëntor- Ministria e Punëve të Jashtme e Malit të Zi ka njoftuar se veprimet e ambasadorit rus, Aleksandar Lukashiq, janë “absolutisht të papranueshme” dhe përbëjnë ndërhyrje në punët e brendshme të Malit të Zi.

Ambasadori rus u thirr për një bisedë në Ministri, pasi ai kritikoi institucionet malazeze. “Ambasadorit rus iu bë e qartë se në të ardhmen mesazhe të ngjashme do të trajtohen si veprimtari qëllimisht armiqësore, ndaj së cilës

Ministria do të reagojë në mënyrë adekuate, në përputhje me normat ndërkombëtare”, u tha në njoftimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Malit të Zi. Arsye për reagimin kanë qenë deklaratat e fundit të Lukashiqit lidhur me vendimin e Kuvendit

për bashkimin e Ushtrisë së Malit të Zi me mekanizmin e NATO-s për ofrimin e ndihmës së sigurisë dhe trajnimit për Ukrainën (NSATU), si dhe komentet e tij negative për intervistën e presidentit Jakov Millatoviq.

KURTI: MBI 12 MIJË GRA TË PUNËSUARA DREJTPËRDREJT NGA PROGRAMET E PUNËSIMIT

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në ngjarjen e organizuar me rastin e shënimit të 20-vjetorit të Agjencisë për Barazi Gjinore në Kosovë. Në fillim të fjalës së tij, kryeministri Kurti tha se është kënaqësi e veçantë të hapim këtë konferencë rajonale në një vit simbolik ku shënohen edhe 30 vjet nga platforma e Pekinit dhe 25 vjet nga miratimi i Rezolutës 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. “Teksa shënojmë këta përvjetorë, riafirmojmë angazhimin e Republikës së Kosovës, si aleate e palëkundur e të drejtave të grave dhe të barazisë gjinore. Edhe pse shumë më e re si Republikë, Kosova i ka përkthyer angazhimet e Platformës së Pekinit në politika konkrete. Një nga shtyllat e kësaj platforme është eliminimi i varfërisë së grave, sepse varfëria nuk është neutrale në aspekt gjinor”, tha kryeministri Kurti. Ndër masat e ndërmarra, ai theksoi punësimin e mbi 12 mijë grave përmes programeve qeverisëse, platformat “Superpuna”, “Qeveria për familjet”, “Kosovo Generation

Unlimited” nga të cilat përfitueset më të mëdha janë gratë dhe vajzat, si dhe faktin se rreth 100 mijë gra kanë hapur llogari bankare për herë të parë në jetën e tyre, falë shtesave për nëna, për fëmijë dhe masave të punësimit për gratë. Mbi qasjen në kapital e në pronë, kryeministri tha se falë masave afirmative për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve pa pagesë, ka pasur përparim të theksuar në dekadën e fundit. Konkretisht deri në vitin 2024 ishin 17,592 prona të regjistruara në krahasim me vetëm 105 sa ishin në vitin 2016. Këtë masë e kemi vazhduar edhe sivjet dhe pronat e regjistruara në emër të të dy bashkëshortëve kanë arritur shifrën 27,830. Pra për më pak se nëntë vjet, numri i pronave të regjistruara në emër të të dy bashkëshortëve është rritur për më shumë sesa 265 herë. Në vijim, kryeministri theksoi se Kosova po zbaton Platformën e Pekinit e cila thotë qartë se arsimi është thelbësor që gratë të arrijnë barazinë gjinore. Arsimin e lartë publik e kemi bërë falas; 15 milionë euro mbështetje direkte për studentët prej tyre afër 7 mijë bursa për vajzat dhe djemtë në fushat STEM, shkencë,



teknologji, inxhinieri dhe matematikë, ku 96% prej përfitueseve janë vajza; 7,423 bursa elitare për studentët me mesatare të lartë 9.0 e mbi, prej tyre 3587 vajza; janë ndërtuar 73 çerdhe të reja; edukimi i hershëm është bërë i detyrueshëm përmes Ligjit për Edukimin e Hershëm; përmes programit të kuponëve, mbulohen shpenzimet e edukimit deri në 150 euro në

muaj për fëmijët 3–5 vjeç nga familjet me asistencë sociale. Kryeministri foli edhe rreth investimeve dhe kujdesit për gratë në shëndetësi si dhe për më shumë drejtësi dhe siguri po e adresojmë dhunën ndaj grave, si çështje të sigurisë njerëzore sipas edhe Platformës së Pekinit dhe Rezolutës 1325. “Megjithë përparimin që kemi arritur si shtet e shoqëri, sfidat për barazinë gjinore vazhdojnë të

jenë të pranishme dhe kërkojnë përkushtimin tonë të pandalshëm dhe për këtë jemi të vëmendshëm e të përkushtuar. Mes presioneve dhe polarizimeve politike, Republika e Kosovës nuk po e relativizon barazinë gjinore. Përkundrazi, po e trajton si thelb edhe të projektit të saj demokratik edhe të vlerës së barazisë shoqërore.” përmbylli fjalën e tij kryeministri Kurti.

AGJENCIA E MENAXHIMIT EMERGJENT: SITUATA ME VËRSHIMET, NËN KONTROLL

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Në pjesë të ndryshme të Kosovës janë raportuar vërshime me “intensitetit të ulët”, tha Agjencia e Menaxhimit Emergjent. Kjo agjenci, që publikoi në Facebook vendbanimet që janë përballur me vërshime, theksoi se gjendja është e “menaxhueshme dhe nën kontroll”. Shiu i madh që filloi të bjerë të hënën natën ka detyruar kryeqytetin Prishtinë ta anulojë mësimin e ditës së martë. Drejtorja e Arsimit në Prishtinë njoftoi në “Facebook” prindërit se mësimi është anuluar si masë parandaluese. “Ju njoftojmë se për shkak të kushteve të përkeqësuar atmosferike, reshjeve të mëdha të shiut dhe vështirësive në komunikacion, në koordinim me Drejtorinë e Sigurisë dhe Emergjencave, Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe drejtorët përkatës të



shkollave, procesi mësimor për ditën e sotme anulohet”, tha Drejtorja e Arsimit. Të hënën mbrëma, Instituti

Hidrometeorologji i Kosovës njoftoi se vendi do të përballej me reshje shiu në dy ditët në vijim, të cilat në disa zona pritet

të jenë të intensitetit të lartë. Të martën, hidrologu Bashkim Kastrati tha për Radion Evropa e Lirë se pjesa perëndimore e

Kosovës është më e rrezikuara nga përmytjet, si pasojë e mundësisë së daljes lumenjve nga shtrati. “Këto reshje mund të shkaktojnë vërshime të shpejta në disa lokalitete”, tha instituti, pa dhënë më shumë hollësi. Ndërkohë, Kompania Rajonale e Ujësjetillësit “Prishtina” paralajmëroi të martën se ekziston rrezik i shtuar për vërshime në zonat e ulëta dhe pranë lumenjve gjatë ditës. Ajo u bëri thirrje qytetarëve t’i shmangin lëvizjet pranë lumenjve dhe kanaleve të ujërave. Kosova është përballur me përmytje vitet e fundit, të cilat kanë shkaktuar kryesisht dëme materiale. Vlerësohet se dëmtimi i shtretërve të lumenjve, si pasojë e nxjerrjeve të paligjshme të zhavorrit, kontribuon shumë në përmytjen e zonave.

Osmani pret në takim ministrin gjerman, Wadephul

Prishtinë, 18 nëntor- Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani ka pritur të martën në takim

ministrin e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Johann Wadephul. Takimi ndërmjet tyre

është duke u mbajtur në presidencës. Të dy pas takimit kanë mbajtur një konferencë

për medie, ku kanë folur për raportet dhe zhvillimet politike ndërmjet dy vendeve.





CLARKU PËRMBYLL DËSHMINË E TIJ NË HAGË: THAÇI NUK MBAN PËRGJEGJËSI PËR AKTET E DHUNËS NË KOSOVË

Wesley Clark, gjeneral i pensionuar amerikan, dëshmoi për dy ditë në mbrojtje të Hashim Thaçit në Hagë. Në ditën e parë të dëshmisë, ai tha se Thaçi s'e udhëhiqte UÇK-në dhe se ajo s'kishte zinxhir komandues. Ndërkaq, në ditën e dytë tha se Thaçi nuk mbante përgjegjësi për aktet e dhunës në Kosovë. Në fund të dëshmisë së tij, ai i kërkoi trupit gjykues që ta lejonte të jepte një vlerësim të tij për rastin gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Ai përsëriti bindjen që Thaçi nuk mban përgjegjësi për aktet e dhunës apo hakmarrjes që kanë ndodhur në Kosovë

Hagë, 18 nëntor- Gjenerali i pensionuar amerikan Wesley Clark, për dy ditë me radhë dëshmoi në mbrojtje të ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, i cili së bashku me ish-kryeparlamentarët Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi dhe ish-deputetin Rexhep Selimi po

gjykohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Të katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mohojnë akuzat ndaj tyre. Clark, gjeneral amerikan me katër yje, dëshmoi para Dhomave të Specializuara në Hagë se Thaçi nuk ishte

komandant ushtarak i UÇK-së dhe sipas tij nuk ishte përgjegjës për këtë organizatë. Ndërsa i pyetur nëse ka qenë e mundur që UÇK-ja të ketë pasur zinxhir komandues funksional me hierarki të plotë e NATO-ja dhe Shtetet e Bashkuara të mos e kenë ditur, Clark tha shkurtimisht: "Jo". "Më kujtohet që e kam parë Thaçin, sepse ishte zëdhënës. ishte i pastër, i veshur mirë, dukej më perëndimor se të tjetër. Nuk dukej se kishte qenë në mal duke luftuar për një-dy vjet rresht. Ishte e qartë se nuk ishte përgjegjës aty, nuk komandonte aty", tha ai më 17 nëntor. Në ditën e parë të dëshmisë, Clark tha po ashtu se nuk besonte që Thaçi komandonte personat që kryen akte të dhunës pas çlirimit të Kosovës. Clark u shpreh se nuk kishte dëgjuar për Shtabin e

Përgjithshëm të UÇK-së dhe as nuk kishte informacione nëse Thaçi kishte luftuar ose jo. Ndërkaq, në ditën e dytë të dëshmisë së tij, gjenerali amerikan u shpreh se UÇK-ja nuk kishte kryer spastrim etnik. Ai tha se i mbetet besnik deklaratave të mëparshme se dhunën në verën dhe vjeshtën e vitit 1999 në Kosovë e shihte si një konflikt shumë personal mes fqinjëve, për të cilën udhëheqësit e UÇK-së nuk kishin përgjegjësi. I pyetur për një deklaratë në gazetën Shekulli në vitin 1999, ku kishte thënë se nuk kishte prova se UÇK-ja ka kryer spastrim etnik të serbëve, Clark tha: "Unë nuk kam prova e as dëshmi që UÇK-ja ishte prapa kësaj, por kam indikacione që dëshmojnë të kundërtën". Clark po i referohej pretendimeve të asaj kohe për

dëbimin e rreth 170.000 serbëve. Nga avokatët mbrojtës dhe prokuroria, Clark u pyet për një sërë çështjesh dhe ngjarjesh, përfshirë edhe për takimet me udhëheqësin e atëhershëm, Slllobodan Millosheviq. Në fund të dëshmisë së tij, ai i kërkoi trupit gjykues që ta lejonte të jepte një vlerësim të tij për rastin gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Ai përsëriti bindjen që Thaçi nuk mban përgjegjësi për aktet e dhunës apo hakmarrjes që kanë ndodhur në Kosovë. "E kam ndjekur këtë gjykim dhe i qëndroj bindjes së mëparshme që Hashim Thaçi nuk është përgjegjës për atë çfarë ka ndodhur në Kosovë. Ai nuk mban përgjegjësi për aktet individuale të dhunës ose të hakmarrjes", tha ai. Sipas Clarkut, UÇK-ja nuk ishte terroriste pasi pjesëtarët e saj

luftuan për lirinë e tyre. “Ata nuk janë terroristë, pavarësisht se kur shkova të takoja gjeneralët serbë ata më thanë që ata janë terroristë. Janë njerëz që luftonin kundër një regjimi të padrejtë, të jashtëligjshëm, që meritonte të largohej dhe të zëvendësohej”, tha ai. Clark kishte shërbyer si komandant Suprem i Forcave Aleate në Evropë për NATO-n nga viti 1997 deri më 2000. Ai udhëhoqi fushatën ajrore kundër cageve serbe, që zgjati 11 javë. Fushata u krye me qëllim që të ndalte dhunën e forcave serbe kundër shqiptarëve në Kosovë. Bombardimet u ndërpre në qershor të vitit 1999, një ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës. Ajo çoi në përfundimin e vrasjeve dhe përfundimisht, vite më vonë, në pavarësimin e Kosovës. Clark shihet si hero në Kosovë për rolin e tij në çlirimin e vendit dhe për këtë ai është nderuar në Prishtinë në vitin 2024 me një dekoratë.

Clark pyetet për kompetencën e Thaçit

Prokuroria e pyeti gjeneralin Clark nëse Thaçi kishte pasur kompetencë politike që ishte e ndryshme nga kompetenca e ushtarëve. “Duket se është kështu”, tha Clark. Gjenerali amerikan në pension tha se UÇK-ja ishte një organizatë rezistence dhe NATO-ja kërkonte që ajo të çarmatosej dhe Serbia të largohej. Prokuroria po ashtu e pyeti nëse ishte e vërtetë që komandantët e zonave kishin deklaruar që ushtria të ishte objekt i autoritetit civil dhe Clark u përgjigj me “po”.

Takimi me Thaçin

Prokurori ia kujtoi atij deklaratën se e kishte takuar Hashim Thaçin në prill 1999 për të kërkuar ndihmën e tij në identifikimin e objektivave për bombardimet e NATO-s. I pyetur nëse i kujtohej se ku ishte mbajtur takimi, Clark tha: “Jam i sigurt që në selinë time”. Më pas, Halling i kërkoi Clarkut të tregojë se në atë kohë cili mendonte se ishte roli i Thaçit. Clark tha: “Ai ishte si oficer ndërlidhës. E kuptova se ai po kërkonte para dhe mbështetje nga diaspora shqiptare”. Clark tha se nuk e di nëse ai po Thaçi e kishte bërë kërkesën për takim. Prokurori i tha se ju u takuat me Thaçin sepse ishte ndër personat më të lartë në UÇK.

Clark: S’mund të konfirmoj nëse UÇK-ja u armatos nga ndonjë shtet i NATO-s

Clark thotë se nuk mund të konfirmojë nëse ndonjë organ

apo entitet qeveritar i ndonjë vendi anëtar të NATO-s i kishte dhënë armë UÇK-së pas nënshkrimit të marrëveshjes së Rambujesë në fillim të vitit 1999. I pyetur nga prokurori Halling nëse nuk mund ta konfirmojë për shkak të konfidencialitetit, Clark tha shkurtimisht: “Thjesht nuk e di”. Prokurori më pas e lexoi një raport informimi të ministrit të atëhershëm të Jashtëm britanik, Robin Cook, lidhur me operacionet e NATO-s, në të cilin ai thotë se “ne kemi marrë disa raporte nga UÇK-ja në dy javët e fundit dhe na ndihmon ta kemi perspektiven e asaj çka po ndodh, por nuk synojmë t’i furnizojmë ata me armë”. Lidhur me këtë Clark tha se “jam i sigurt ka pasur deklarata nga dikush që ka thënë se UÇK-ja ka trokitur në derë për të kërkuar ndihmë, kjo është tërësisht ndryshe nga të pasurit një sistem të komandës dhe kontrollit, të unifikuar, i cili do të mbështeste NATO-n”. Clark përsëriti se UÇK-ja nuk kishte komandë kontrolli.

Clark e mohon se nuk donte komunikim me UÇK-në

Clark e mohoi se kishte thënë se “ishte e rëndësishme të mbahej njëfarë lloji distance nga UÇK-ja gjatë bombardimeve”, kur prokurori citoi një deklaratë të tij nga një intervistë. I pyetur nëse ai nuk donte të kishte komunikim me UÇK-në asokohe, Clark tha: “Jo, nuk është e saktë”. “Për këtë arsye fola me Thaçin. Në fakt, i kërkova Thaçit të na ndihmonte. Ishim në një pikë kritike të

historisë, vlerave, etikës dhe demokracisë në atë kohë. Dua të shpjegoj se në një pikë kur njerëzit luftojnë kundër shtypjes, ata kalojnë nga të qenët terroristë, në luftëtarë lirie, dhe në një pikë të caktuar, opinionin botëror dhe konsensusin botëror vjen në përfundim se njerëzit të drejtë t’i bëjnë ballë trysnisë së luftës dhe kjo është e shkruar edhe në deklaratën e pavarësisë së SHBA-së”, shpjegoi Clark. Clark shtoi: “Nga viti 1974 Kosova duhej të ishte shtet i ndarë administrativ, por [lideri i atëhershëm serb Sllobodan] Millosheviqi ua mohoi këtë, prandaj një grup i caktuar njerëz që quheshin terroristë u bënë mbrojtje kolektive e popullit të vet”.

Cilësimi i veprimeve të UÇK-së

Clark po pyetet tani për cilësimet që ia bënin ndërkombëtarët Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në fillimet e saj. Halling i kërkoi atij të tregojë nëse është e vërtetë që veprimet e para të UÇK-së cilësoheshin si terroriste nga bashkësia ndërkombëtare. “Ka pasur diskutime lidhur me këtë pikë. Më kujtohet që ambasadori Robert Gelbard e kishte quajtur terroriste familjen Jashari. Por, ai u qortua për këtë dhe deklarata e tij u tërhoq dhe u korrigjuar”. Halling e lexoi një deklaratë që Clark e kishte bërë më 1998, ku kishte thënë “E dënojmë dhunën kundër personave që kanë shprehur orientimin e tyre politik në mënyrë jo të

dhunshme, po ashtu dënojmë metodat terroriste që përdoren për të arritur synime të caktuara”. Kur prokurori i tha se “pra edhe ju vetë i keni lidhur veprimet e asaj kohe që po ndodhin në Kosovë me veprime terroriste”, Clark u përgjigj duke shpjeguar se “metoda terroriste kam dënuar unë”.

Clark pyetet për zemërimin e komandantit të KFOR-it me Thaçin

Tani prokurori Halling e lexoi një përmbledhje të komandantit të KFOR-it, Klaus Reinhardt, (1999-2000), i cili kishte folur në një konferencë për media me Hashim Thaçin, ku kishte shprehur shqetësim për gjendjen në Luginën e Preshevës dhe e kishte dënuar përdorimin e dhunës atje. Reinhardt tha se “Thaçi e akuzoi palën serbe që kishte filluar dëbimin e shqiptarëve dhe pretendoi se ata ishin detyruar të iknin nëpër bjeshkë me gjësendet e fundit të tyre dhe nuk e tha asnjë fjalë për t’u distancuar nga UÇPMB-ja dhe nuk foli për sigurinë. Ai e bëri të kundërtën duke folur rrejshëm dhe duke bërë propagandë”. “I thashë që keqpërdori besimin tim dhe i thashë që më ka zhgënjyer shumë dhe se nuk do të dalë më para kamerave më të. Gjenerali Clark po ashtu më tha se ishte i inatosur, sepse Thaçi i kishte premtuar diçka krejt tjetër”. I pyetur nëse i kujtohet kjo ngjarje e përshkruar nga Reinhardt, Clark tha: “Po, më kujtohet”. Megjithatë, i pyetur nëse është

përshkrim i saktë, Clark tha: “Nuk kam qenë atje dhe nuk e di çfarë ka ndodhur. Por, e di që ishte një situatë ku po bëhej kalimi i UÇK-së nga një organizatë ushtarake dhe rezistence në një person që kërkonte të siguronte të ardhmen politike për veten dhe Kosovën”. “Unë kam lexuar që ka pasur dhunë ndaj shqiptarëve në Luginën e Preshevës”, tha Clark. Sa për dijeni, UÇPMB, apo Ushtria Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, ishte një grup i armatosur shqiptar që veproi në Luginën e Preshevës (Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc) gjatë viteve 2000-2001. Ajo u shpërbë pas marrëveshjes së Konçulit në vitin 2001, ku pjesëtarët e saj u çarmatuan nën mbikëqyrjen e KFOR-it dhe NATO-s.

Clark: UÇK-ja nuk ka kryer spastrim etnik

Clark i mbetet besnik deklaratave të mëparshme se dhunën në verën dhe vjeshtën e vitit 1999 në Kosovë e shihte si një konflikt shumë personal mes fqinjëve, për të cilën udhëheqësit e UÇK-së nuk kishin përgjegjësi. I pyet për një deklaratë në gazetën Shekulli në vitin 1999, ku kishte thënë se nuk kishte prova se UÇK-ja ka kryer spastrim etnik të serbëve, Clark tha: “Unë nuk kam prova e as dëshmi që UÇK-ja ishte prapa kësaj, por kam indikacione që dëshmojnë të kundërtën”. Clark po i referohej pretendimeve të asaj kohe për dëbimin e rreth 170.000 serbëve.



DËSHMIA E WESLEY CLARKUT, E VËRTETA E LUFTËS NË KOSOVË



Shkruan: Akademik
Arsim BAJRAMI



Gjeneral Wesley Clark, me dëshminë e tij para Gjykatës Speciale, po dekonspiron dhe rrëzon akuzën e padrejtë të ngritur nga kjo gjykatë lidhur me të ashtuquajturën “ndërmarrje e përbashkët kriminale” të UÇK-së. Ai, përmes deklarimeve të tij të qarta dhe profesionale, konfirmon karakterin mbrojtës të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe demanton të gjitha paragjykimet dhe narrativat e pavërteta të përhapura ndër vite nga kjo gjykatë.

Më poshtë po paraqes një fragment nga libri im Konferenca e Rambujesë dhe Intervenimi i NATO-s në Kosovë, ku pasqyrohet dukshëm roli vendimtar i gjeneral Clark në procesin e çlirimit të Kosovës. Gjenerali i Brigadës së “US Army”, Uesli Clark (Wesley Clark), është figura më rëndësishme në luftën e Kosovës. Ai ka shërbyer si komandant i Komandës së Aleancës në Evropën Perëndimore gjatë luftës në Kosovë dhe ishte pjesë e operacionit NATO të emërtuar “Forca e Veriut”, e cila kryente sulmet ajrore për të mbrojtur popullsinë e Kosovës nga sulmet e forcave serbe.

Roli i Uesli Klarkut në këtë kontekst ishte në koordinimin dhe udhëheqjen e forcave ajrore të NATO-s që kryen sulmet ajrore në mbështetje të popullsisë së Kosovës. Ai ka pasur një rol udhëheqës në udhëzimin e operacioneve ushtarake dhe në sigurimin e mbrojtjes së

popullsisë civile nga represionet e forcave serbe. Veprimet e tij në këtë periudhë e bënë të njohur si një luftëtar për lirinë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë gjatë konfliktit në atë zonë.

Ish-komandanti i lartë i NATO-s, Uesli Klark, i cili drejtoi bombardimet kundër forcave serbe në vitin 1999, tha në një intervistë për shërbimin rus të Zërit të Amerikës se bombardimet e ndaluan spastrimin etnik në Kosovë dhe NATO-ja nuk kishte zgjidhje tjetër. Ai tha se përpjekje për ta shmangur luftën në Kosovë ishin bërë që në fillim të viteve të 90-ta, kur Perëndimi u bë i ndërgjegjshëm për gjendjen e rëndë në Kosovë. Atëherë, presidenti Xhorxh H. Bush (George H. Bush) e paralajmëroi presidentin serb Slllobodan Millosheviq se do të përballej me pasoja të rënda nga Shtetet e Bashkuara, nëse fillon spastrimin etnik të shqiptarëve të Kosovës, në atë që quhej “Paralajmërimi i Krishtlindjeve”, në dhjetor të vitit 1992.

Gjenerali Klark e përshkroi situatën e rëndë në Kosovë dhe shkëljet e shumta të të drejtave të njeriut nga autoritetet serbe. Ai kujtoi sulmin mbi familjen Jashari në fshatin Prekaz të komunës së

Skenderajt, në Kosovën qendrore, në fillim të vitit 1998, ku u vranë 54 anëtarë të familjes, që shënoi edhe fillimin e luftës së armatosur. Më tej, ai deklaroi: “NATO-ja lëshoi një paralajmërim në takimin e ministrave në muajin maj dhe pastaj unë mora detyrën të përgatisja planet në maj të vitit 1998. Ambasadori Riçard Hollbruk shkoi në qershor dhe u takua me Slllobodan Millosheviqin. Ai më lidhi në telefon me të dhe i thashë “Të lutem, mos ua bëj këtë shqiptarëve! Ai më tha, gjenerali Clark, ata janë njerëzit e mi dhe nuk do t’i lëndo. Por, sigurisht kjo ishte një gënjeshtëri, sepse spastrimi etnik tashmë po ndodhte”.

Ai tha se kishin vazhduar paralajmërimet dhe në vjeshtën e vitit 1998. Kombet e Bashkuara e miratuan Rezolutën 1199 të forcuar me planin e veprimit të NATO-s. Përpjekjet e të dërguarit amerikan Kristofer Hill nuk dhanë rezultate, ndërsa pas Masakrës së Reçakut, një fshat në jug të Prishtinës, ku u vranë 45 civilë shqiptarë, filloi procesi i negociatave në Rambuje. “Atje Serbia refuzoi ta nënshkruajë marrëveshjen që i jepte Kosovës vetëqeverisje thelbësore dhe parashihte vendosjen e trupave të NATO-s në terren për të siguruar zbatimin e marrëveshjes. NATO-ja pas spastrimit të ri etnik të shkallës së gjerë në mars të vitit 1999, nuk pati zgjidhje tjetër përveç ndërhyrjes”, vijoi ai.

“Ne përdorëm forcën vetëm si zgjidhjen fare, fare të fundit. Por, NATO-ja nuk mund të lejonte një raund të ri të spastrimit etnik nga serbët. Sapo kishim ndaluar një gjë

të tillë në Bosnjë dhe nuk mund të lejonim një gjë të tillë të ndodhte sërish në Kosovë dhe prandaj u përgjigëm me forcë, pasi provuam të gjitha mundësitë e tjera. Dhe, pasi që rusët refuzuan të ndihmojnë. Pikëpamja ruse ishte se kjo është çështje e brendshme serbe dhe nëse ata duan të vrasin një milion njerëz, kjo është e drejta e tyre. Por, kjo nuk është pikëpamja jonë. Ne besonim në të drejtën e çdo individi që të ketë liri dhe dinjitet në pajtim me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe nuk mund të lejonim që tragjedia njerëzore ta godiste sërish Kosovën”.

Gjenerali Klark i hodhi poshtë pohimet ruse, sipas të cilëve ka pasur shumë të vrarë nga bombat e NATO-s dhe ndërhyrja e saj ishte e paligjshme dhe e padrejtë. Ai përmendi faktin se para se të goditej ndërtesa e Radiotelevizionit të Serbisë, Slllobodan Millosheviqi ishte paralajmëruar në mënyrë që të shmangeshin viktimat. “Ideja nuk ishte të vriten njerëzit, por të ndërpritej spastrimi etnik në Kosovë, që po e kryenin trupat e tij dhe ai nuk mund t’i shmangej përgjegjësisë”. Ai përmendi fshehjen e trupave të shqiptarëve të vrarë, përfshirë edhe zbulimin e kamionit frigorifer me trupat e shqiptarëve në Serbi. NATO-ja, tha ai, bëri gjënë e duhur, ndaloi spastrimin etnik.

Gjenerali Uesli Klark ka rrëfyer gjatë një interviste në emisionin “Opinion” takimin e tij me Millosheviqin lidhur me çështjen e Kosovës. Ndër të tjera, ai ka treguar takimin me ish-presidentin serb në vjeshtën e vitit 1998, duke dhënë këto fragmente nga

diskutimi i tij me Millosheviqin, i cili atij i kishte thënë: “Gjeneral Klark, dimë ne si të sillemi me këta shqiptarët, këta vrasësit, përdhunuesit, kriminelë si vetë ata. E kemi bërë edhe më parë. I vramë. I vramë të gjithë.” Më tutje, Millosheviqi i kishte thënë Klarkut: “Gjeneral, nëse ju na lini, ne do t’i vrasim të gjithë ata. I vramë në ‘46-ën. Na u desh shumë kohë, por i vramë të gjithë.”

Ky kërcënim filloi të zbatohet kur 1.4 milionë shqiptarë u dëbuan nga shtëpitë e tyre, 900 mijë ikën në Maqedoni dhe në Shqipëri, 500 mijë fshiheshin pyjeve të Kosovës. Serbët po i ndiqnin dhe po përpiqeshin t’i vrisnin. Më tutje, Klarku shtoi se “ne i dhamë fund tërë kësaj dhe jam krenar për atë çfarë bëri NATO-ja”. Ishte vizita e treta që bëra në Beograd, pasi NATO-ja nxori urdhrin e aktivizimit, “Activation Order”, shtator, 1998. Në vizitën e parë, gjeneral Naumani i kërkoi Millosheviqit të tërhiqte forcat shtesë. Solana i tha, po ashtu. Millosheviqi u mundua ta mohonte që ato forca ishin atje. Nuk u tërhoqën. Në vizitën e dytë, i udhëzuar nga Shtëpia e Bardhë, shkova ta takoja Millosheviqin dhe i thashë se do ta bombardonim, nëse s’i tërhiqte ato forca. Tha, në rregull, fol me gjeneralët e mi! Kur flisim me ta, thoshin se ka terroristë këtu, këtu e këtu dhe na e tregonin me gisht hartën. U thosha se ishin thjesht njerëz që mundohen t’i mbrojnë familjet e tyre. Sa herë të vrisni, do të bëni më tepër armiq. Nuk mund të fitoni me këto taktika. Jo, nuk dëgjonin ata.

Kurti uron Bedri Hamzën për zgjedhjen kryetar i PDK-së

Prishtinë, 18 nëntor- Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryeministër në detyrë, Albin Kurti, ka uruar Bedri Hamzën për zgjedhjen kryetar i PDK-së.

Kurti ka theksuar se proceset zgjedhore brenda partisë, por edhe bashkëpunimi i ndërsjellët i spektrit të gjerë politik, çdo herë në të mirë të

interesit publik, janë parime themelore për funksionimin dhe avancimin e shtetit tonë. “I shpreh urimet e mia z. Bedri Hamzës për zgjedhjen e tij në detyrën e kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës. Proceset zgjedhore brenda partisë, por edhe bashkëpunimi i ndërsjellët i spektrit të gjerë politik, çdo herë

në të mirë të interesit publik, janë parime themelore për funksionimin dhe avancimin e shtetit tonë. Nga ana ime, do të vazhdoj angazhimin për bashkëpunim korrekt, në përputhje me vullnetin e qytetarëve, dhe me përgjegjësitë që na i kërkon shërbimi ndaj Republikës”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.



KOSOVA FTOHET TË MARRË PJESË NË EXPO 2030, QË DO TË MBAHET NË RIAD TË ARABISË SAUDITE



PRISHTINË, 18 NËNTOR - Pas paraqitjes së suksesshme të institucioneve të Kosovës në EXPO 2025, në Osaka të Japonisë, të martën në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, zëvendësministri Kreshnik Ahmeti pranoi ftesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Arabisë Saudite për pjesëmarrjen e Republikës së Kosovës në EXPO 2030.

Ftesa u dorëzua nga ambasadori jo-rezident i Arabisë Saudite për Republikën e Kosovës, Faisal Ghazi Hivzi.

Gjatë takimit, Ahmeti konfirmoi interesimin e Kosovës për të qenë pjesë e kësaj ngjarjeje botërore, e cila pritet të mbahet nga 1 tetori 2030 deri më 31 mars

2031.

EXPO 2025 në Osaka u vizitua nga 28 milionë njerëz nga mbarë bota, të cilët patën mundësinë të kuptojnë më shumë edhe për Republikën e Kosovës.

Kjo paraqitje u shndërrua në një platformë të jashtëzakonshme për krijimin e marrëdhënieve të reja ekonomike, kulturore, arsimore dhe diplomatike.

EXPO, në nivel botëror, është një nga ngjarjet më të mëdha ndërkombëtare, e cila organizohet çdo pesë vite, dhe i kushtohet inovacionit, zhvillimit dhe bashkëpunimit botëror, ku shtetet paraqesin arritjet e tyre dhe krijojnë bashkëpunime për të ardhmen.

AGK-ja PO IMPLEMENTON NISMËN ECOVOICES PËR FUQIZIMIN E GAZETARËVE TË RINJ NË RAPORTIMIN MJEDISOR

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka njoftuar se është krenar që po implementon nismën EcoVoices, e cila krijon hapësirë për gazetarë të rinj dhe aktivistë nga komunitete të ndryshme etnike që të avokojnë për drejtësi mjedisore dhe të drejtën për një mjedis të shëndetshëm për të gjithë. Pas trajnimit të tetorit për raportimin mjedisor, ngjarja e Green Forum mbledhi së bashku redaktorë të mediave dhe pjesëmarrësit e rinj, të cilët prezantuan idetë e tyre për storje



multimediale dhe artikuj që adresojnë sfidat mjedisore në komunitetet e tyre. 20 gazetarë të rinj kanë përfituar aftësi të reja,

mjete praktike dhe mentorim të drejtpërdrejtë nga redaktorë profesionistë.

AGK-ja ka theksuar se mbetet e përkushtuar në mbështetjen e gazetarëve të rinj dhe në promovimin e reportimit cilësor mbi çështjet mjedisore, që prekin të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kjo nismë EcoVoices realizohet në kuadër të projektit “Përf forcimi i hapësirës qytetare, kohezionit social dhe modeleve inovative të angazhimit publik”, të implementuar nga UNDP Kosovo.

BESNIK TAHIRI: SA MË E FORTË TË JETË KOMUNA, AQ MË I FORTË ËSHTË SHTETI

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Nën kryetari i AAK-së, Besnik Tahiri, ka marrë pjesë në konferencën e organizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), në të cilën ka folur për proceset integruese dhe rolin që ka pushteti vendor në këtë drejtim.

Ai ka theksuar se në sisteme politike si ai i Kosovës, ku komuna është institucioni më relevant për ofrimin e shërbimeve publike, forcimi i kapaciteteve të saj është thelbësor për të ofruar menaxhim efikas të financave publike dhe për të prodhuar



rezultate pozitive në kuadër të kriterëve të BE-së, siç janë qeverisja e mirë, shërbime cilësore dhe respektimi i të drejtave të njeriut dhe pakicave. “Sa më e fortë të jetë komuna, aq më i fortë është shteti”, ka thënë Tahiri.

Për nëntë muaj morën trajtim mjekësor në QKUK 77 mijë e 655 pacientë

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Në Klinikën Emergjente të Qendrës Klinike dhe Universitare e Kosovës (QKUK), në nëntëmujorin e parë të vitit 2025, trajtim mjekësor kanë marrë, 77 mijë e 655 pacientë. “Ky trajtim

është ofruar nga 23 specialistë emergjent, 6 specialistë internist, 4 kardiolog dhe 92 infermier/e, që paraqet numrin më të madh të infermierëve dhe mjekëve nga paslufta, në këtë klinikë. Kontribut të çmuar kanë

dhënë edhe profilet e tjera mjekësore, përmes konsultimeve, sikurse edhe degët diagnostike. Nga numri i përgjithshëm, 18 mijë e 329 pacientë, janë trajtuar në dhomën e reanimimit, 23 mijë e 810 shërbime internistike, 13

mijë e 730 në atë kirurgjike, si dhe 16 mijë e 475 raste ortopedike. Gjatë kësaj periudhe, në Emergjencë janë kryer 972 operacione kirurgjike. Po ashtu, 5 mijë e 329 intervenime në sallën e vogël”, ka njoftuar ShSKUK.



PRODHUESIT NË KRIZË: LIBERALIZIMI I ENERGJISË RRITI ÇMIMET, ULI KAPACITETET

Rritja mbi 100% e çmimit të rrymës, pas liberalizimit të tregut të energjisë, ka detyruar shumë biznese t'i pezullojnë punësimet dhe të ndalojnë zgjerimin e linjave prodhuese. Nga 27 kompani të licencuara për tregtim, vetëm pak operojnë realisht në treg, duke e bërë konkurrencën minimale dhe çmimet e furnizimit pothuajse të pandryshueshme. Bizneset po kërkojnë zgjidhje tek energjia diellore për të ulur varësinë nga tregu i hapur dhe për të mbrojtur të ardhurat dhe vendet e punës, ndërsa ZRRE-ja thotë se nuk ka pranuar asnjë ankesë zyrtare

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Procesi i liberalizimit të tregut të energjisë në Kosovë ka goditur rëndë bizneset prodhuese, duke rritur ndjeshëm kostot dhe duke kufizuar mundësitë e tyre për zgjerim dhe punësim. Kompania "Pestova" në Vushtrri, e cila merret me përpunimin dhe prodhimin e patates dhe numëron 260 punëtorë të rregullt, ka ndaluar një linjë të re prodhimi dhe ka pezulluar punësimin e 20 punëtorëve të rinj, për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë. Edhe pse ka shpenzuar 4% më pak rrymë në shtator të këtij viti, fatura e saj është rritur nga 10.962 euro në 25.535 euro - një rritje mbi 100% krahasuar me vitin e kaluar. Pronari Bedri Kosumi thotë se politika e kompanisë për të mbajtur cilësinë dhe çmimet konkurruese është vënë në pikëpyetje; planet për zgjerim dhe rritje të pagave janë pezulluar, ndërsa pajisjet për produkte të reja mbeten të papërdorura në depo. "Politikë e kompanisë është që të jemi më të mirët në kualitet, por edhe më të lirët në raftet e dyqaneve. Pas liberalizimit, është zvogëluar marzha e fitimit aq shumë, sa që jemi në pozitë shumë të vështirë", thotë Kosumi për Radion Evropa e Lirë. Në situatë të ngjashme është edhe kompania "Cadi Cleaning" në Ferizaj, e cila prodhon produkte pastrimi. Me një staf prej 75 punëtorësh, ajo nuk po arrin të lidhë kontrata të reja me klientë vendorë dhe ndërkombëtarë, për shkak të rritjes mbi 100% të koston së energjisë elektrike. Pronari Sadri Gashi thotë se është detyruar të pezullojë çdo plan për zgjerim të prodhimit dhe të ndalojë punësimin e stafit të ri. Duke folur për Radion Evropa e Lirë, ai tregon se këtë muaj ishte në Gjermani, për të negociuar marrëveshje me një kompani gjermane, por thotë se përpjekja nuk dha rezultat. "I kam ofruar çmimin për furça tualeti prej 0.45 centësh për copë, por klienti më ka treguar se në Gjermani e merr të njëjtin

produkt për 0.42 centë - pa kosto transporti. Në këto kushte, është e pamundur të konkurrojmë", thotë Gashi. Çmimet e energjisë dyfishohen. Nga 1 qershor, me vendim të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), bizneset më të mëdha në Kosovë - me mbi 50 punëtorë dhe qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro - kanë kaluar në treg të hapur të energjisë. Kjo do të thotë se këto biznese nuk furnizohen më me tarifa të rregulluara, por blejnë energjinë sipas ofertave të kompanive private, të licencuara për tregtim. Sipas ZRRE-së, në këtë proces janë të përfshira rreth 1.300 biznese, që konsumojnë rreth 37% të energjisë së përgjithshme. Ky numër bazohet në të dhënat e vitit 2024, ndërsa të dhënat e këtij viti tregojnë një situatë ndryshe. Sipas Administratës Tatimore të Kosovës, në muajin shtator, numri i kompanive me më shumë se 50 punëtorë dhe qarkullim mbi 10 milionë euro ishte 976. Nga Shoqata e Prodhuesve të Kosovës thonë se këto kompani më parë paguanin rreth 75 euro për megavat rrymë, ndërsa tani çmimi ka shkuar deri në 190 euro për megavat, duke përfshirë edhe tarifën shtesë. Çmimi ndryshon varësisht nga shpenzimi, niveli i linjës në tension dhe bursa energjetike. Sipas Kushtrim Ajvazit, udhëheqës i Shoqatës së Prodhuesve të Kosovës, nga 300 kompani që kanë dalë në treg të hapur të energjisë, vetëm 60 kanë mundur të sigurojnë kontrata me çmim fiks deri në fund të dimrit. "... pra, jemi në një situatë ku bizneset, edhe pse po paguajnë dyfish e gjysmë më shtrenjtë, në njëfarë mënyre, janë gëzuar që kanë arritur ta fiksojnë çmimin deri në fund të dimrit, duke filluar nga muaji nëntor", thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Ajvazi shpjegon se një kompani prodhuese, e cila për konsum energjetik në muajt maj, qershor, korrik, gusht dhe



shtator të vitit 2024 ka paguar 46.564 euro, për të njëjtën sasi të energjisë këtë vit pagoi 117.707 euro. "Ka biznese që janë mbyllur, ka biznese që planet investive për këtë vit i kanë ndërprerë, kurse rritjen e pagave e kanë pezulluar", thotë ai. Të gjitha këto probleme, sipas përfaqësuesve të bizneseve, burojnë nga fakti se procesi i liberalizimit të energjisë nuk është përgatitur siç duhet. Për këtë arsye, Oda Ekonomike e Kosovës dorëzoi edhe një padi në Gjykatën Supreme kundër ZRRE-së. Ka pasur, gjithashtu, edhe protesta publike, por ZRRE-ja thotë se, deri më tani, nuk ka pranuar ndonjë ankesë përmes procedurave zyrtare.

Furnizimi dhe mungesa e konkurrencës


Në Kosovë, megjithëse janë të licencuara 27 kompani për tregtim me energji elektrike - dhe tri të tjera në proces licencimi - tregu mbetet i përqendruar dhe konkurrenca thuajse nuk ekziston. Në mesin e operatorëve janë edhe Operatori për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) dhe Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). Por, sipas Ajvazit, udhëheqës i Shoqatës së Prodhuesve të Kosovës, vetëm tri ose katër kompani kanë prani reale dhe mund të negociojnë drejtpërdrejt çmimin. "Mungesa e konkurrencës së fortë bën që çmimet të mbeten të larta", sipas tij. Kur Radio Evropa e Lirë kontaktoi disa prej kompanive të licencuara për t'i pyetur për

çmimet dhe mundësitë e furnizimit, vetëm KESCO dhe ENERCO LLC dhanë përgjigje. KESCO ka kontrata aktive me mbi 460 biznese, por nuk pranoi të specifikojë çmimin për kilovat apo megavat, duke thënë se ai ndryshon sipas kontratës dhe llojit të marrëveshjes. ENERCO LLC, në anën tjetër, furnizon rreth 80 biznese aktive. Çmimet, sipas kompanisë, luhaten mes 120 dhe 140 eurosh për megavat, në varësi të tregut ditor dhe marrëveshjeve bilaterale. E, sipas ZRRE-së, në treg aktualisht janë aktivë tetë operatorë, ndërsa KESCO mban portofolin më të madh të konsumatorëve komercialë në tregun e hapur.

Çfarë zgjidhjeje mund të ketë?

Shoqata e Prodhuesve të Kosovës kërkoi nga Qeveria e vendit që ta shtyjë zbatimin e vendimit për daljen e kompanive në treg të hapur të energjisë dhe t'i mbështesë bizneset në sigurimin e një prone për investime të përbashkëta në energji diellore. Sipas Ajvazit, disa kompani prodhuese janë të gatshme të ndërtojnë një plantacion diellor me kapacitet prej 500-600 megavatesh, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë. "Shteti le të na sigurojë tokën dhe t'i përfundojë procedurat sa më shpejt. Kostoja që paguajmë për energji elektrike shkon jashtë Kosovës; këto mjete nuk kthehen në vend", thotë ai. Sipas tij, investimi do të mund të rikuperohej brenda 20 vjetësh, do të krijonte vende të reja pune dhe

do t'i mbante të ardhurat financiare brenda vendit. Qeveria në detyrë nuk iu përgjigj pyetjes së Radios Evropa e Lirë se a e ka shqyrtuar kërkesën e përfaqësuesve të prodhuesve, derisa disa kompani po tentojnë të gjejnë zgjidhje vetë. Kosumi i kompanisë "Pestova" thotë se vitin e ardhshëm do të nisë instalimin e paneleve diellore. "Nuk e kemi pasur në plan, por tani është e domosdoshme. Bazuar në ofertat e deritanishme, panelet dhe bateritë shkojnë mbi një milion euro", thotë ai. Liberalizimi i energjisë në rajon. Procesi i liberalizimit të tregut të energjisë në Bashkimin Evropian filloi që në fund të viteve '90, me qëllim rritjen e konkurrencës, efikasitetit, sigurisë dhe zgjedhjes për konsumatorët. Në Ballkanin Perëndimor, ky proces është ende në zhvillim. Në Kosovë, ai u parapa me Ligjin për energjinë elektrike të vitit 2016, por zbatimi u shty, për shkak të rrethanave të ndryshme. Procesi shkaktoi kundërshtime edhe në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut, por sot shihet si mundësi për të kontrolluar më mirë shpenzimet. Përndryshe, liberalizimi i tregut të energjisë është edhe kërkesë e BE-së përmes Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të nënshkruar në vitin 2005 nga vendet e rajonit, përfshirë Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Serbinë, Malin e Zi, Bosnje dhe Hercegovinën, Bullgarinë, Rumaninë dhe Kroacinë. Traktati i detyron vendet që të harmonizojnë legjislacionin dhe të zbatojnë hapjen graduale të tregjeve.



Bayerni insiston për Fisnik Asllanin

BAYERN, 18 NËNTOR - Interesimi i Bayern Munchenit për sulmuesin e Kosovës, Fisnik Asllani po bëhet gjithnjë e më konkret, pasi bisedimet e para mes palëve tashmë janë zhvilluar. Në proces janë

përfshirë drejtuesit Max Eberl dhe Christoph Freund pasi bavarezët janë mjaft të impresionuar nga zhvillimi i sulmuesit kosovar. Asllani 23 vjeç, po kalon një sezon fantastik me Hofenheimin dhe do të

largohet në verë falë një klauzole lirimi të përfshirë në kontratën e tij. Forma e tij e shkëlqyer ka tërhequr vëmendjen e disa klubeve të mëdha evropiane, por Bayerni shihet si destinacioni më i interesuar dhe

më konkret deri tani. Sulmuesi aktualisht në grumbullim me Kosovën, ku edhe po shkëlqen me fanellën e "Dardanëve". Asllani po kërkohet edhe nga Barcelona, Chelsea, Tottenhami e disa skuadra tjera angleze.



"PENDOHET" JUVENTUSI, TANI E DUAN ME ÇDO KUSHT GRANIT XHAKËN

TORINO, 18 NËNTOR - Raportet në Itali pretendojnë se Juventus është i etur të rikthehet në idenë e nënshkrimit të Granit Xhakës gjatë afatit kalimtar të janarit, vetëm gjashtë muaj pas rikthimit të tij në Ligën Premier me Sunderlandin. Sipas gazetës italiane "Tuttosport", Juventus është i etur të shtojë forcë në departamentin e mesfushës, i cili është bërë tepër i varur nga Khephren Thuram dhe Manuel Locatelli, dhe se

Bianconerët janë të etur për idenë e nënshkrimit përsëri të Xhakës. Reprezentuesi zviceran kishte qenë një opsion për Zonjën e Vjetër gjatë afatit kalimtar të verës, kur ai ishte i disponueshëm për një tarifë prej 15 milionë eurosh. Sipas raportit, Xhaka nuk i kishte plotësuar të gjitha kërkesat e Juventusit gjatë verës, shqetësimi i dukshëm ishte mosha e tij, pasi ka mbushur 33 vjeç në shtator. Megjithatë, Juventus tani është i vetëdijshëm për faktin



se ka nevojë për opsione të reja në mesfushë "me çdo kusht" dhe beson se Xhaka u ofron atyre vlerën më të mirë për paratë, edhe nëse është vetëm disa muaj në qëndrimin e tij me Sunderland.

Sipas "Tuttosport", Juventus është i vetëdijshëm se do të kushtojë më shumë se 15 milionë euro plus bonuset që Sunderland i pagoi Bayer Leverkusen gjatë verës nëse do të përpiqen të arrijnë një marrëveshje gjatë afatit kalimtar të janarit.

BETEJA MILIONA DOLLARËSHE MES PSG-së DHE MBAPPES

PARIS, 18 NËNTOR - Beteja miliona dollarëshe mes PSG-së dhe Kylian Mbappes është intensifikuar, ndërsa avokatët e të dyja palëve janë para Këshillit të Prud'hommes, organi francez që merret me konfliktet e punës. Në këtë seancë, ku lojtari nuk ishte i pranishëm, po paraqiten kërkesa të jashtëzakonshme financiare, me pretendime që kapin shifrën e qindra milionë eurove. Mbappe, i cili tashmë është pjesë e Real Madridit, pretendon se PSG-ja i ka borxh rreth 55 milionë euro nga paga dhe bonuset e vitit të fundit të kontratës së tij. Por kërkesa e tij ka shkruar shumë përtej kësaj shume fillestare. Sipas avokatëve të tij, ai kërkon mbi 260 milionë euro kompensim, që përfshijnë pagesa të prapambetura, dëmshpërblime për pushim të padrejtë, bonus nënshkrimi,



shpërblime të pa paguara dhe pretendime të tjera si "punë e padrejtë", "ngacmim moral" dhe shkelje të detyrimeve të sigurisë nga ana e klubit. Në listë

përfshihen shifra si 44.6 milionë euro për largim të padrejtë, 40.4 milionë euro bonus nënshkrimi, 37.5 milionë euro për ngacmim moral, 37.5 milionë euro për

punë të padrejtë, si dhe 19 milionë euro paga të prapambetura për periudhën prill-qershor 2024. Nga ana tjetër, PSG-ja nuk ka mbetur pas dhe ka kaluar në kundërsulm. Klubi kërkon 60 milionë euro dëmshpërblim dhe gjithashtu 180 milionë euro, që përfaqësojnë shumën e paguar dikur për transferimin e Mbappe nga Monaco, duke u mbështetur në konceptin juridik francez "perte de chance", humbje e mundësisë, me arsyetimin se lojtari u largua falas dhe i shkaktoi klubit humbje të konsiderueshme financiare.

Përplasja ka nisur pasi Mbappe ka kaluar te Real Madrid dhe ka pretenduar se PSG-ja kishte vendosur në mënyrë të njëanshme të mos i paguante rreth 55 milionë euro. Klubi,

megjithatë, ka këmbëngulur se lojtari kishte premtuar se nuk do të largohej kurrë falas dhe se kishte rënë dakord të hiqte dorë nga kjo shumë, pas një takimi të zhvilluar pak para fillimit të Ligue 1 me presidentin Al-Khelaifi dhe drejtorin sportiv Luis Campos. Pikërisht pas atij takimi ai është rikthye në stërvitje me ekipin e Luis Enriques, pasi më parë ishte përjashtuar dhe nuk ishte marrë në turneun parasezonal në Japoni, si pasojë e vendimit të tij të 2023-ës për të mos rinovuar kontratën. Rasti pritet të zgjasë për disa muaj para se të merret një vendim, ndërsa beteja ligjore midis Mbappe dhe PSG-së po kthehet në një nga konfliktet më të mëdha dhe më të kushtueshme mes një futbollisti dhe klubit në historinë moderne të futbollit.

Benzema mbështet Zidanen për rolin e trajnerit të Francës

PARIS, 18 NËNTOR - Sulmuesi i Al-Ittihad dhe ish-ylli i Francës, Karim Benzema, beson se Zinedine Zidane është i përshtatshëm për postin e trajnerit të ekipit kombëtar. Zidane ka lënë të kuptohet para disa ditësh se është afër

rikthimit si trajner dhe kombëtarja e Francës është ekipi më i përfolur që ai mund ta marrë për ta drejtuar. I këtij mendimi është edhe ish-ylli i tij te Real Madridi, Benzema, i cili beson se Zidane është adekuat për stolin e "Gjelave".

"Mendoj se ai ka gjithçka që duhet për të qenë atje. Ai e ka provuar këtë te Real Madridi. Tani ka një trajner tjetër, por mendoj se Zidane është numri një", ka thënë ish-ylli i Real Madridit. Trajneri aktual i "Les Bleus",

Didier Deschamps, pritet të japë dorëheqjen nga pozicioni i tij pas Kupës së Botës 2026. Ndërkohë, Zidane, i cili ka qenë prej kohësh i lidhur me ekipin kombëtar, kohët e fundit la të kuptohet se rikthimi i tij në menaxhim është i afërt.



F2.3/BNJ



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM "Pastrimi" Sh. A. konkretisht neni 11, paragrafi 1.2 dhe neni 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve me nr. protokolli 01/14/37 të datës 02/09/2025, bazuar në Vendimin e KE-së me nr. protokolli 02/01/670 të datës 29/08/2025, bazuar në Vendimin e KE-së për pozitat test me nr. protokolli 7096 të datës 15/11/2024, bazuar në Vendimin e datës 17/11/2025 me numër të protokollit 06/03/6342 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i Vendit të punës: Mbikëqyrës i Mirëmbajtjes së Hapësirave dhe Higjienës Publike
Nr. i kërkuar: Një (1) pozitë, NJO Obiliq në KRM "Pastrimi" SH.A
Numri i Referencës: KP/PT/NJO/ 36-2025
Koeficienti/Paga mujore: Niveli X
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar
Periudha Provuese: 3 muaj

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- 1.1 Mbikëqyr punën e Kryepunëtorëve në Njësi Operative,
- 1.2 Zbaton Planin Operative të Njesisë Operative,
- 1.3 Përgatit raporte ditore, javore, mujore dhe vjetore për proceset e punës,
- 1.4 Përcjell nevojat në teret dhe paraqet kërkesa në bazë të tyre,
- 1.5 Mbështet dhe ndihmon kryepunëtorët dhe punëtorët sipas nevojës,
- 1.6 Kryen detyra të tjera shtesës sipas Përgjegjësi i Njesisë Operative,
- 1.7 Për punën e tij i raporton përgjegjësit të Njesisë.

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në ligj.

3. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Të jesh i kujdesshëm dhe t'i kushtosh vëmendje detajeve;
- ✓ Aftësia për të punuar vetë;
- ✓ Aftësitë e shërbimit ndaj klientit;
- ✓ Njohuri për sigurinë publike;
- ✓ Aftësia për të punuar mirë me duart e tua;
- ✓ Formë fizike dhe qëndrueshmëri;
- ✓ Aftësia për të organizuar kohën dhe ngarkesën e punës;
- ✓ Aftësi të mira të komunikimit verbal.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Kërkesa për punësim dhe CV-ja, e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
Dëshmi të kualifikimeve shkollore nga Institucionet Arsimore (e dëshirueshme)	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	✓
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)	✓
Dokument identifikimi i Republikës së Kosovës	✓
Vërtetim nga Gjykata që personi nuk është nën hetime, JO më të vjetër se 6 muaj	✓

5.1 Shkollimi: Shkollim i mesëm

5.2 Përvoja e punës: 1 Vite përvojë pune

6. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:

6.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:

- * duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A.
- * në recepcionin e kompanisë.

6. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:

6.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:

- * duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A.
- * në recepcionin e kompanisë.

6.2 Dorëzimi i aplikacionit:

- * Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe
- * Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitat teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

7. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 18/11/2025 deri me datën 03/12/2025.
Koha e fundit e pranimi të aplikimeve është ora 16:00.
Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të:

- ✓ CV-së së kandidatit: deri në 25 pikë
- ✓ Intervistimi: deri në 75 pikë.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronit dhe individualisht.

10. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,
Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.
Publikimi i rezultateve bëhet deri në 3 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "03 Power" Shpk, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Impiantin Fotovoltaik me kapacitet 4.545 MW në Shusicë dhe Mojstir", Komuna Istogut.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.01.2026 në ora 10:00 në SHF "Mehmet Akif" në Shushicë të Istogut, do të organizohet debat publik nga "03 Power" Shpk, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "03 Power" Shpk, Prishtinë, për Pëlqim Mjedisor, për Impiantin Fotovoltaik me kapacitet 4.545 MW në Shusicë dhe Mojstir", Komuna Istogut.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

F2.3 / BNJ



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" A. D.

Na osnovu Zakona o radu br. 03 / L-212, posebno član 8, u Uredbi br. 07/2024 o radnom odnosu u RPO "PASTRIMI" a.d., posebno član 11. stav 1.2 i član 12, u Uredbi br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "PASTRIMI" a.d. A, na osnovu Odluke Upravnog odbora sa br. Protokol 01/14/37 od 02/09/2025, na osnovu Odluke EK br. Protokol 02/01/670 od 29.08.2025. godine, na osnovu Odluke EK o ispitnim pozicijama br. Protokol 7096 od 15.11.2024. godine, na osnovu Rešenja od 17.11.2025. godine sa brojem protokola 06/03/6342 glavnog izvršnog direktora RPO-a "PASTRIMI" a.d. Ah, objavite ovo:

JAVNI KONKURS
Za popunjavanje posla

Naziv radnog mesta: Supervizor za održavanje prostora i javnu higijenu
Ne. Potreban: Jedna (1) pozicija, NJO Obilic u RPO "PASTRIMI" A.D.
Referentni broj: KP / PT / NJOO / 36-2025
Mesečna plata: Nivo X
Trajanje ugovora o radu: Na neodređeno vreme
Probni period: 3 meseca

1. Dužnosti i odgovornosti:

- 1.1 nadzire rad glavnih radnika u Operativnoj jedinici,
- 1.2 sprovodi operativni plan operativne jedinice,
- 1.3 Priprema dnevne, nedeljne, mesečne i godišnje izveštaje o radnim procesima,
- 1.4 prenosi potrebe u oblastima i podnosi zahteve na osnovu njih,
- 1.5 Podržava i pomaže predradnike i radnike po potrebi,
- 1.6 obavlja i druge dodatne poslove prema rečima šefa Operativne jedinice,
- 1.7 On izveštava o svom radu šefu Jedinice.

2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

- ✓ Budite državljanin Republike Kosovo,
- ✓ da poznaje najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti u stanju da obavlja relevantan zadatak;
- ✓ Ne biti osuđen za počinjenje krivičnog dela;
- ✓ Ne bi trebalo da postoji disciplinska mera na snazi za ozbiljan prekršaj u javnoj ustanovi;
- ✓ Imajte veštine potrebne za poziciju
- ✓ Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene u zakonu.

3. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- ✓ Budite oprezni i obratite pažnju na detalje;
- ✓ Sposobnost da rade samostalno;
- ✓ Veštine korisničkog servisa;
- ✓ Poznavanje javne bezbednosti;
- ✓ Sposobnost da dobro rade sa rukama;
- ✓ Fizički oblik i izdržljivost;
- ✓ Sposobnost organizovanja vremena i obima posla;
- ✓ Dobre veštine verbalne komunikacije.

5. Dokumenti koji se podnose kao deo prijave i kako ih dostaviti

Zahtev za zapošljavanje i CV, popunjen i potpisan od strane kandidata	✓
Dokaz o školskoj spremi iz obrazovnih ustanova (poželjno)	✓
Kopije dokaza o zaposlenju (penzijski fond, sertifikat ili ugovor o radu)	✓
Kopija sertifikata o obuci i kursu (poželjno)	✓
Kopije ocena rada za poslednje dve godine (poželjno)	✓
Identifikacioni dokument Republike Kosovo	✓
Potvrda Suda da osoba nije pod istragom, NE starija od 6 meseci	✓

5.1 Školarina: Srednje obrazovanje

5.2 Radno iskustvo: 1 godina radnog iskustva

6. Kako se prijaviti na konkurs i poslati prijavu:

6.1 Povlačenje zvaničnih obrazaca se vrši:

- * preuzimanjem sa zvanične stranice na društvenoj mreži Facebook: Regionalno preduzeće za otpad "Pastrimi" a.d.
- * na recepciji kompanije.

6.2 Podnošenje prijave:

- * Prijava za zapošljavanje, sa popunjenom dokumentacijom, podnosi se isključivo elektronskim putem na adresu: punesimi.krmpastrimi@gmail.com u PDF formatu i
- * U slučajevima internih i eksternih takmičenja za tehničke pozicije, to se može uraditi i u fizičkom obliku preko arhive kompanije.

7. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od 18.11.2025. do 03.12.2025. godine.
Rok za prijem prijava je 16:00 časova.
Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće biti razmatrane.

8. Metod evaluacije i kriterijumi ocenjivanja.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno stotinu (100) bodova, pri čemu je prohodnost postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog takmičenja.

Ocenjivanje kandidata se zasniva na:

- ✓ biografije kandidata: do 25 bodova
- ✓ Intervjuisanje: do 75 bodova.

9. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Približan kalendar postupka zapošljavanja:

Faza prethodne verifikacije prijava do 7 dana;
Pismena faza testiranja do 10 dana nakon faze verifikacije,
Faza intervjuja do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.

Objavljivanje rezultata vrši se do 3 dana nakon evaluacije intervjuja.

Napomena: Nepotpuni, neskenirani dokumenti, kao i oni koji stignu nakon isteka roka za dostavu konkursa, neće biti pregledani.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Saranda Gjonaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e Gjimanzit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



Në bazë të nenit 8, pika 1 e 2 e Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 7 të UA 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe vendimit nr. 738/07.11.2025, KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A, me datë 18.11.2025 shpall këtë:

RISHPALLET
KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e një pozite:

1. Titulli i punës: **Zyrtar për pasuri dhe asete**

Numri i references: 761
Vendi: Gjakovë

Ndërmarrja : Kompania Regjionale e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A

Kohëzgjatja e punës: Në kohë të caktuar me mundësi vazhdimi, puna provuese (6) gjashtë muaj në pajtim me Ligjin e Punës.

- Niveli i pagës: Vlera e pagës bazë 616.70 euro.

Kompania Regjionale e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A është Ndërmarrje Publike që në kuadër të veprimtarisë së saj përfshin grumbullimin dhe ofrimin e shërbimit me ujë për ujitjen e tokave bujqësore që shtrihen në perimetrimin e sistemit të ujitjes në tri komunat të Gjakovës, Rahovecit dhe Prizrenit. Kompania Regjionale e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A dëshiron që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit si dhe plotësojnë kushtet e pavarësisë dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara :

- Fakulteti Ekonomik, Financa, Biznes apo të ngjashme;
- Minimum 3 vite përvojë pune
- Aftësi për përmbyshje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (office)

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Mban shënime të sakta për të gjitha pasuritë, duke përfshirë vendndodhjen, gjendjen dhe vlerën e tyre;
- Zbaton një sistem të fuqishëm të gjurmimit të aseteve për të monitoruar lëvizjen dhe përdorimin e aseteve;
- Në bashkëpunim me njësitë përkatëse zhvillon oraret e mirëmbajtjes për të siguruar që asetet mirëmbahen dhe mbahen në gjendje të mirë;
- Koordinon mirëmbajtjen dhe riparimet për të minimizuar kohën e ndërprerjes dhe për të zgjatur jetëgjatësinë e aseteve;
- Monitoron amortizimin e aseteve dhe llogarit vlerën e tyre në rënie me kalimin e kohës;
- Siguron pajtueshmërinë me standardet dhe rregulloret e kontabilitetit në lidhje me zhvlerësimin e aseteve;
- Identifikon rreziqet e mundshme që lidhen me pronësinë e aseteve, të tilla si vjedhja, dëmtimi, shfrytëzimi, ose keqpërdorimi dhe tjetërsimi;
- Planifikon heqjen e aseteve që nuk janë më të dobishme ose me kosto efektive për ndërmarrjen;
- Identifikon mundësitë për zëvendësimin e aseteve për të përmirësuar efikasitetin dhe performancën;
- Përgatitë dhe dorëzon raporte mbi përdorimin, vlerën dhe performancën e aseteve palëve të interesuara;
- Eksploron teknologjitë në zhvillim, si sensorët identifikimi dhe teknologji tjetër, për të përmirësuar monitorimin e aseteve;
- Bashkëpunon me departamente të ndryshme, për të siguruar që nevojat për asete të përmbyshen;
- Analizon të gjithë ciklin e jetës së aseteve, nga blerja deri te nxjerrja jashtë përdorimit, për të marrë vendime të informuara për zëvendësimet dhe përmirësimet;
- Për punën e vetë i përgjigjet Zyrtarit Kryesor Financiar;
- Regjistrimin e mjeteve themelore dhe inventarit në(financa /material);
- Regjistrimin (kontimin) e hyrjeve dhe daljeve nga magazine në (financa/ material);
- Kryen edhe detyra tjera shtesë të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga Zyrtari Kryesor Financiar/Kryeshefi Ekzekutiv;
- Për punën e tij/saj i përgjigjet ZKF-së;

Procedura për aplikim

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Një C.V. e detajuar.
- Kopja e dokumentit identifikues.
- Letër motivimi.
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale te noterizuara.
- Dëshmi mbi përvojën në punë, si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe aftësive.
- Referenca nga punëdhënësit paraprak.
- Certifikata nga gjykata kompetente që nuk është subjekt hetimi për kryerjen e veprës penale, nuk është në procedure penale dhe nuk është i dënuar nga gjykata kompetente për kryerjen e një veprë penale jo me te vjetër se 6 (gjashtë) muaj.
- Aplikacionet mund të tërhiqen në KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A që gjendet në Gjakovë rruga e UÇK-së. Nr. 7, ose në faqen zyrtare të kompanisë: <https://kruradoniqi-dukagjini.com/>

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet vetëm në formën elektronike në e-mail zyrtarë të kompanisë: kruradoniqi-dukagjini@hotmail.com
Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, afati i fundit për aplikim është data 03/12/2025 deri në ora 16:00

Vërejtje: Kandidatet me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe pas afatit të konkurrit do të refuzohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatet të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe të përfshirë në listën e ngushte.



Na osnovo člana 8, tačka 1 i 2 Zakona o radu Republike Kosovo, člana 5 i 7 AU 01/2024 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, kao i Odluke br. 738/07.11.2025, RKN Radoniqi-Dukagjini S.A, od 18.11.2025. godine, objavljuje sledeće:

PONAVLJANJE JAVNOG KONKURSA

Popunjavanje radnih mesta:

1. Naziv posla: **Službenik za bogatstvo i imovinu**
Referentni broj: 761
Lokacija: Đakovica

Preduzeće: Regionalna kompanija za navodnjavanje Radoniki-Dukagjini D. D.

Trajanje rada: Određeno vreme sa mogućnošću produženja, probni rad od (6) šest meseci u skladu sa Zakonom o radu.

- Nivo plate: Osnovna vrednost plate 616,70 evra.

Regionalno preduzeće za navodnjavanje Radoniki-Dukađini, DD, je javno preduzeće koje, u okviru svoje delatnosti, obuhvata prikupljanje i pružanje usluga vodosnabdevanja za navodnjavanje poljoprivrednog zemljišta koje se prostire unutar perimetra sistema za navodnjavanje u tri opštine: Đakovica, Orahovac i Prizren. Regionalno preduzeće za navodnjavanje Radoniki-Dukađini, DD, želi da svi potencijalni kandidati budu osobe visokog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove, kao i uslove nezavisnosti, i da poseduju neophodno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju.

Potrebni zahtevi i kvalifikacije:

- Fakultet ekonomije, finansija, biznisa ili slično;
- Minimum 3 godine radnog iskustva
- Sposobnost za obavljanje zadataka i rad pod pritiskom;
- Poznavanje rada na računaru sa softverskim aplikacijama

Dužnosti i odgovornosti:

- Vodi tačnu evidenciju o celoj imovini, uključujući njenu lokaciju, stanje i vrednost;
- Implementira robustan sistem za praćenje imovine radi praćenja kretanja i korišćenja imovine;
- U saradnji sa relevantnim jedinicama, razvija rasporede održavanja kako bi se osiguralo da se imovina održava i da se čuva u dobrom stanju;
- Koordinira održavanje i popravke kako bi se minimiziralo vreme zastoja i produžio vek trajanja imovine;
- Prati amortizaciju imovine i izračunava njihov pad vrednosti tokom vremena;
- Obezbeđuje usklađenost sa računovodstvenim standardima i propisima u vezi sa amortizacijom imovine;
- Identifikuje potencijalne rizike povezane sa vlasništvom nad imovinom, kao što su krađa, oštećenje, eksploatacija ili zloupotreba i otuđenje;
- Planira odlaganje imovine koja više nije korisna ili isplativa za preduzeće;
- Identifikuje mogućnosti za zamenu imovine radi poboljšanja efikasnosti i učinka;
- Priprema i podnosi izveštaje o korišćenju, vrednosti i učinku imovine zainteresovanim stranama;
- Istražuje nove tehnologije, kao što su senzori za identifikaciju i druge tehnologije, radi poboljšanja praćenja imovine;
- Sarađuje sa različitim odeljenjima kako bi se osiguralo da su potrebe za imovinom zadovoljene;
- Analizira ceo životni ciklus imovine, od nabavke do povlačenja iz upotrebe, kako bi donosio informisane odluke o zameni i poboljšanjima;
- Izveštava glavnog finansijskog direktora o svom radu;
- Evidentira osnovna sredstva i zalihe u (finansije/materijal);
- Evidentira (računovodstveno obračunava) skladišne prijemnice i isplate u (finansije/materijal);
- Obavlja i druge dodatne poslove koje glavni finansijski direktor/generalni direktor može razumno povremeno zahtevati;
- Odgovara za svoj rad glavnom finansijskom direktoru;

Postupak prijave:

- Potrebna dokumentacija:
- Detaljna biografija (CV).
- Kopija identifikacionog dokumenta.
- Motivaciono pismo.
- Overeni dokaz o stručnoj obuci.
- Dokaz o radnom iskustvu, kao i drugi dokazi zasnovani na kvalifikacijama i veštinama.
- Preporuke prethodnih poslodavaca.
- Uverenje nadležnog suda da nije predmet istrage za počinjeno krivično delo, da nije u krivičnom postupku i da nije osuđivan od strane nadležnog suda za počinjeno krivično delo, ne starije od 6 (šest) meseci.
- Prijave se mogu podneti u KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A koja se nalazi u Đakovici, ulica UÇK br. 7, ili na zvaničnoj veb stranici kompanije: <https://kruradoniqi-dukagjini.com/>

Popunjena dokumentacija se dostavlja isključivo u elektronskom obliku na zvaničnu imejl adresu kompanije: kruradoniqi-dukagjini@hotmail.com
Konkurs ostaje otvoren petnaesti (15) kalendarskih dana, rok za prijavu je 03.12.2025. do 16:00 časova.

Napomena: Kandidati sa nepotpunom dokumentacijom, nepotpune prijave i prijave podnete nakon isteka roka za konkurs biće odbijeni. Kontaktirajte se samo kandidati koji ispunjavaju navedene uslove i koji su uvršteni u uži izbor.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

